



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **20.04.2021**, me fillim në ora **10.00**.  
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

**REND DITE**

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar – mars 2021,**
3. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2019 – 2020 në vitin 2021,**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 05864-0 Rahovec,**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës se paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 07111-1 Rahovec,**
6. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 02352-0 Rahovec,**
7. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 00251-0 Çifllak,**
8. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020,**
9. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021-2025,**
10. **Të ndryshme.**

**Kryesuesi** – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e ditës:  
Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar** – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë dikush diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e vë në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar e KPF-së, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**2. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar – mars 2021.**

**Afrim Limani** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së. Kam kënaqësinë që para juve të paraqes raportin 3-mujorë financiar ne periudhën janar – mars 2021. Ky raport 3-mujor financiar përfshin dy pjesë, pra pjesën e të hyrave dhe pjesën e realizimit të buxhetit. Por, raportit i mungojnë edhe aktivitetet e prokurimit për arsye se nuk i kemi parë të arsyeshme me i futë këto aktivitete sepse edhe ashtu nuk ka pasur ndonjë aktivitet apo ngjarje gjate kësaj periudhe. Pjesa e të hyrave përbëhet prej të hyrave të rregullta, nga pjesa e të hyrave të gjobave të gjykatave dhe trafikut të cilët i mungojnë këtij raporti që akoma nuk e kemi një raport të tillë dhe shpresoj që për mbledhjen e kuvendit të na vijë një raport sa i takon kësaj dhe ti inkorporojmë në pjesën e raporteve. Pastaj i kemi të hyrat edhe sipas kategorive ekonomike, të pjesa e shpenzimit të buxhetit e kemi të raportuara shpenzimin e buxhetit sipas programeve dhe kategorive ekonomike dhe krejt në fund i kemi shpenzimet komunal. Sa për informimin tuja në pjesën e të hyrave, nëse bëjmë një krahasim nga periudha e njëjtte e vitit të kaluar atëherë kemi një ngritje simbolike të të hyrave, afër 36,975 euro pra fjala është për të hyrat e rregullta. Kështu që presim raportin nga gjobat e gjykatave dhe trafikut dhe besoj që diferenca ka me qenë edhe me e mirë. Të pjesa e buxhetit është shpenzuar në shumën prej 3,897,000 apo në përqindje 27,42%. Kështu që unë nuk do flas tani me shume, jam në dispozicionin tuaj për ndonjë pyetje.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sjelljen e raportit, unë kam një pyetje për sqarim në faqe 9 të raportit, pikërisht të kodi 14020 kuvendi komunal 5000 euro dhe kodi 14310 vlera për dreka zyrtare 1774 euro. Kisha kërkuar nga ju drejtor, një sqarim rreth kësaj.

**Florida Bajraktari** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. E falënderoj drejtorin për sjelljen e këtij raporti financiar për periudhën janar – mars 2021. Unë do të ndalem në faqe 5, tek krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike për vitin 2020-2021, ku të disa kode kemi ndryshime të mëdha, si p.sh. tek kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi, realizimi për këtë 3-mujor për vitin 2020 ka qenë 542 euro kurse realizimi për vitin 2021 është 7967 euro. Pastaj të kodi 500026 taksa për legalizimin e objekteve, në vitin 2020 realizimi ka qenë 14,733 euro që është një shume e madhe nëse e krahasojmë me vitin 2021, pasi ky realizim në këtë 3-mujor është 2479 euro. Kështu që do të ishte mirë ta sqaroni këtë se pse është ky ndryshim i madh.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët e drejtorive dhe gjithë që janë prezentë në këtë sallë. E falënderoj drejtorin e Financave për sjelljen e këtij raporti financiar të përgatitur për këtë 3-mujorin e parë të këtij viti janar – mars 2021. Pra, është një raport i qartë, ku shihet se të hyrat në këtë 3-mujor në raport me vitin e kaluar janë më mirë edhe në raport me planifikimin që është tejkaluar, kështu që mendoj se është bërë një punë e mirë në këtë drejtim. Drejtori e ceku se të hyrat nga gjobat nuk janë në këtë raport, kështu që unë kisha kërkuar nga ju që nëse arrini me i pas deri në mbledhje të kuvendit do të ishte mirë me na prezantua dhe me i pas në material që me ditë sa janë këto të hyra. Në faqe 5, edhe unë kisha ndërhyje tek krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike, që janë disa kode ekonomike që po shihet se është një diskrepancë e madhe e të hyrave në raport me planifikimin psh kodi 50013 taksa për certifikata të lindjes pastaj 50026 taksa për legalizimin e objekteve, pastaj kemi kodin 50405 shfrytëzimi i pronës publike, që edhe këtu është dallimi i madh, kështu që nëse bëhet krahasimi me planifikimin atëherë shihet se deri në fund të vitit do të ketë të hyra shumë pak dhe për këtë kemi nevojë për sqarim. Pastaj të kodi participimet në shëndetësi 50409, planifikimin e keni cekur 61,000 që unë mendoj se planifikimi për vitin 2021 mos e keni gabim sepse është 41,000 e jo 61,000 siç është e shkruar, që është shënuar një zbritje në raport me vitin 2000 që ka qenë 50,000 e pastaj të hyrat kanë afër 41,000 dhe aq janë të planifikuara sipas planit buxhetor për vitin 2021 dhe kornizës afatmesme buxhetore. Pastaj faqe 6, planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë, që shihet edhe këtu është tejkaluar planifikimi dhe e çmoj këtë sepse mendoj se kjo është kategoria me e mirë dhe me stabile, ku ne edhe si delegatë kemi kërkuar që të gjenden forma që të realizohen të hyrat në këtë drejtim dhe besoj që do të shkon ky trend deri në fund të vitit. Në faqe 8, tek shpenzimet në bazë të kategorive ekonomike, të pagat dhe mëditjet që është shqetësuese për

mua është shpenzimet ne raport me planifikimin, ku shpenzimet për paga dhe mëditje janë mbi 2 milion dhe nëse krahasojmë këto me planifikimin vjetor atëherë po del që për 3 mujorin e parë janë shpenzuar diku mbi 97,000 euro me shumë se sa planifikimi dhe kjo është pak shqetësuese pasi e dimë se shpenzimet te pagat janë fikse dhe nuk duhet me qenë më të mëdha se sa janë të planifikuara, pasi është e kuptueshme te kategoritë tjera mirëpo te pagat jo sepse ne fund do te kemi deficit nëse shkohet ne këtë mënyrë. Pra, do të thotë edhe këtu me na dhanë një sqarim pse janë shpenzuar me shume në kategorinë e pagave dhe mëditjeve se sa janë planifikuar. Këto janë disa nga sqarimet që kërkoj nga ju.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive dhe gjithë ju të pranishëm. Kolegët parafolës paraprakisht i ceken disa gjëra edhe unë do të ndërlidhem aq sa mundem me dhanë kontributin rreth kësaj. Kur jemi tek të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore për vitin 2020-2021. Siç e ceken edhe parafolësit se është tejkaluar planifikimi d.m.th. realizimi është më i madh se planifikimi, kështu që unë desha me pyet drejtorin që çka ka ndikuar që realizimi i të hyrave të rregullta të jetë më i madh se planifikimi apo është fjala për keq planifikim, pasi kur e kemi bërë planifikimin nuk i kemi paraparë gjërat mirë, pra kjo është sa i përket faqes 3. Pastaj te faqe 4, drejtori tha se nuk kemi shënimet për gjokat nga gjykatat dhe trafikun, por drejtorit i sugjeroj që për mbledhje të kuvendit edhe te gjokat e gjykatave dhe trafikut, fjalia të përmirësohet në mes pasi që është e shënuar gabimisht, pasi shkruan gjokat nga e gjykatave 2021 dhe po ashtu edhe e trafikut e njëjta gjë është, kështu që të përmirësohet dhe të behet fjali e plotë, pra kjo është ne faqe 4 tek tabela e parë dhe e dytë te gjokat e gjykatave dhe trafikut. Pra, duhet të përmirësohen pasi fjalia është e gjymtuar dhe e pakuptimtë dhe për mbledhje të kuvendit të sjellët ashtu siç duhet pa gabime. Pastaj në faqe 5, u përmenden disa kode që realisht kanë ndryshime nga viti 2020 në vitin 2021 edhe sigurisht ju drejtor do i jepni ato sqarime siç u ceken me herët nga Florida dhe Fehmi Cena, se pse ndodh ai ndryshim me një kod në mënyrë shumë të madhe pasi është ndryshime shumë i madh por ajo çka desha të potencoj është që ne e kemi tabelën që na keni dërguar ju d.m.th. 1.6 krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike për vitin 2021, kurse ju e keni bërë 2020, pra këtu bëhet fjalë për raportin 3-mujor. Kështu që planifikimi në shtyllën e parë është për krejt vitin dhe desha të them që kur është 3-mujor atëherë le të mbetet kjo shtyllë por duhet të shtohet edhe një shtyllë tjetër, ku planifikimi është vetëm për 3-mujorin p.sh. krejt këtë planifikim mundesh me nda në katër pjesë pasi që i kemi katër 3-mujore dhe ne 3-mujorin e parë te jetë ¼ e kësaj shume për të gjitha shënimet siç e keni bërë p.sh. ne faqen 6 për planifikimin e realizimit të tatimit në pronë, që e keni punuar shumë mirë, që te planifikuara për vitin 2021 janë 41,632 euro kurse janë te realizuara mbi 45,000 kështu që është bërë më shumë realizimi, pra do të ishte mirë të sqaroheni pasi këto shuma që janë vjetore të jenë për 3-mujorin e parë, që me pas mundësi me ditë se sa është realizimi për vitin 2021, pra të krijohet tabela e ndarë në shtylla si për 3-mujor, 6-mujor, 9-mujor dhe një vit, pra do të ishte mirë me u përmirësua kjo dhe me qenë e qartësuar. Te kategoritë ekonomike konsideroj që afërsisht ka shkuar mirë puna dhe shpenzimi është bërë në rregull dhe e di që nuk mbetet asnjë cent por duhet me cekë ne këtu pasi tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve e kemi më pak të shpenzuar buxhetin karshi sa është i planifikuar për vitin 1,715,447 euro kurse janë shpenzuar 303,763 euro d.m.th. që i bie më pak se ¼ e buxhetit por unë jam i bindur që deri në fund të vitit do të shpenzohet krejt.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjet, së pari kryesuesi i bëri dy pyetje rreth shpenzimit te buxhetit ne kuadër te mallra dhe shërbime ne kuvend, mirëmbajtja e ndërtesave 5000 euro dhe dreka zyrtare ne vitin 2020 ishin 1770 euro ndërsa për shumen 5000 euro sa per informimin tuaj janë shpenzime te mirëmbajtjes dmth ne e kemi te kontraktuar një kompani e cila i mirëmban objektet e komunës dhe pjese e shpenzimit te buxhetit është edhe kuvendi pasi ajo kompani edhe kuvendin e pastron edhe ka pasur mjete kështu që ne e kemi shpenzua që mos me lanë me shkua ne suficite, kështu që e kemi shfrytëzuar dhe i kemi pague obligimet ne kuadër te asaj kompanie. Te drekat zyrtare për vitin 2020 ne shumen prej 1774 euro, pasi edhe vitin e kaluar e keni bërë te njëjtën pyetje edhe ju kam përgjigjur juve kryesues, që realisht kuvendi nuk e ka bërë këtë shpenzim mirëpo kuvendi i komunës se Rahovecit e ka marr këtë vendim që nga viti 2013 pasi ne atë kohë isha edhe unë pjese e asamblesë komunale dhe ne atë kohë kuvendi e ka nxjerr një vendim për pagesën e shpenzimeve të shoqatës “Eksodi99”, pra ky shpenzim është në kuadër të Eksodit 99 dhe ju kisha lutur juve kryesues që sa me shpejt që është e mundur ta shfuqizojmë atë vendim sepse e konsideroj se është

e paarsyeshme dhe e e palogjikshme është që të paguajmë shpenzime për dreka zyrtare, pasi ata i kryejnë aktivitetet e veta dhe e gjitha na faturohet neve si komunë i gjithë shpenzimi, absolutisht nuk jam kundër pasi komuna eventualisht mundet me ndihmua me ndonjë pagesë për aktivitetet e tyre mirëpo jo për dreka zyrtare. Kështu që kërkesa jonë është që ta kemi ne konsideratë këtë dhe ta shfuqizojmë këtë vendim. Pastaj Florida Bajraktari i ngriti disa pyetje kryesisht taksa për leje ndërtimi dhe taksa për legalizim të objekteve. Ju e dini se edhe vitin e kaluar kemi pasur të njëjtin problem për shkak të një programi, pasi siç e dini këto janë të hyra në kuadër të drejtorisë së urbanizimit. Pra për shkak të një programi softveri që është aty që do të thotë realisht ne mënyrë të kundërt kanë shkuar dhe tash brenda këtij viti e kemi rregulluar atë problem dhe të hyrat regjistrohen ashtu siç duhet e jo ne mënyrë anasjelltas. Po ashtu edhe Fehmi Cena ngriti disa pyetje rreth të hyrave, që realisht pajtohem edhe unë pasi kemi problem sidomos tek të hyrat në kuadër të drejtorisë së administratës pasi vërtet është vazhdimisht kemi problem me programin e softverit sepse nuk e bën regjistrimin në mënyrë adekuate p.sh. taksa për certifikata të lindjes realisht pagesa regjistrohet të kunorizimi apo dikun tjetër. Por ajo që është me e rëndësishme këto të hyra janë kryesisht në kuadër të drejtorisë së administratës. Te planifikimi i të hyrave në kuadër të shëndetësisë prej 61,000 euro realisht nuk e di tani për tani pasi deri para dy dite kam qenë i angazhuar shumë me auditorë dhe pak rëndësi i kam dhënë edhe këtij raporti sepse e kemi përgatit me një kohë shumë të shpejtë edhe nuk kemi mundur me u barazua me Ministrinë e Financave por gjithsesi për mbledhje të kuvendit do të merr një përgjigje të saktë. Te shpenzimi i buxhetit për paga, realisht ky shpenzim është real sepse ministria e Financave i ka bërë pagesën e punëtorëve shëndetësorë ajo pjesa shtesë për aktivitete ju që i bëni në kohë pandemie, edhe për inspektorët është gjeneralë sepse ky buxhet është i shpenzuar. Krejt nuk i ka pague ministria prej buxhetit të vet por këto janë shpenzime në kuadër të buxhetit të komunës, por sigurisht pjesën e mbetur të buxhetit me rishikim të buxhetit do të bëjmë alokim shtesë, edhe pse për këtu nuk e kemi aq shumë problem pasi pozicioni i pagave është një kategori e ndjeshme që do të thotë se gjithsesi ata duhet me plotësua. Pastaj pyetjet e parashtruara nga Rasim Fazliu dhe besoj që përgjigja ime është e njëjtë sikur ju dhashë edhe asamblistëve tjerë dhe për ato gabime apo korrigjime sigurisht se do ta kemi ne konsideratë dhe mos raporti i të hyrave rreth shpenzimit e kam thënë edhe me herët dhe po e them edhe tani se planifikimi i të hyrave është ministria e Financave që na cakton limitet apo tavanet edhe në kuadër të atij planifikimi në duhet me shkue me reduktime. Edhe faktikisht të hyrat përafërsisht deri mbi 200 euro duhet me qenë me të larta mirëpo ministria e Financave i cakton limitet sa duhet edhe mbi bazën e atyre ne duhet me ju përmbajt asaj.

**Rasim Fazliu** – I nderuari drejtor, të të hyrat po më intereson se ne i kemi të paraqitura këtu të përgjithshme por pyetja ime është se a keni ju shënime që obligimet që po i kryejnë njerëzit se a janë për këtë 3-mujor pra vitin 2021 apo keni mundësi me i nda pasi dikush bënë pagesa edhe të viteve paraprake që ka pasur borxhe që me ditë që a po mbledhet tatimi për vitin 2021 tash apo janë edhe të viteve paraprake edhe futen krejt bashkë, veç këtë po dua me dit se a i keni shënimet rreth kësaj çështje.

**Afrim Limani** – Të gjitha janë paraqitura në mënyrë të qartë pasi realisht këto të hyra që po i diskutojmë janë në kuadër të këtij viti fiskal pra vitit 2021 kurse për pjesën tjetër të hyrave, ne e kemi mbajtur mbledhjen gjat muajit shkurt, ku pjesa e tepricës se të hyrave edhe ato janë bartur në kuadër të projekteve ekzistuese. Pra ne mbledhjen e shkurtit i kemi diskutuar sa e kemi pasur dhe këtë vit e kemi pasur afërsisht 488,000 euro të cilat janë bartur në vitin 2021 në kuadër të obligimeve, pra të obligimeve financiare apo kontraktuale të cilat i kemi bartur. Ndërsa këto janë të planifikuara në kuadër të buxhetit për vitin 2021 që pjesa dërmuese e këtyre të hyrave është në kuadër të investimeve kapitale, pra 311,000 euro janë të planifikuara sepse ligji mbi financat publike dhe përgjegjësi e përcakton qartë se subvencionet duhet të mbulohen nga të hyrat vetanake. Kështu që na subvencione i kemi të buxhetuara 311,000 atëherë këto mjete ndahen për mbulimin e subvencioneve dhe pjesa tjetër është në kuadër të investimeve kapitale. Deri me tash kemi arrit me inkasue diku 390,000 euro dhe i kemi mbuluar një pjesë të subvencioneve ndërsa pjesa tjetër në kuadër të projekteve kapitale, kontratat të cilat pritet me u lidhë sepse pa u alukue buxheti nuk mundemi me lidh asnjë kontratë, kështu që po duhet në mënyrë precize me ju përshtat kontratat dhe me alokim të mjeteve.

**Fehmi Cena** – Tek pyetja që e kontestova, shpenzimet për pagat dhe mëditjet dhe drejtori e dha një përgjigje, kështu që shpenzimet me tepër janë për shkak të pagesave shtesë në shëndetësi, pra kështu ishte përgjigja e drejtorit. Tash unë i kam dy nën pyetje, se a është kjo që i marrin punëtorët e rregullt shtesat apo

është Caritasi që merr pjesën tjetër shtesë të pagave, pra me na precizue. Dhe tjetra është se a është vetëm shëndetësia që ka shënuar këtë rritje apo ka edhe ndonjë program tjetër që ka shpenzime më shumë se sa planifikim. Pra nëse nuk keni shpjegim për sot drejtor atëherë mundeni për mbledhje të kuvendit me na sqarue, pasi janë edhe dikastere tjera që ndoshta edhe arsimit po shpenzon më shumë se sa që është planifikua e jo ti mbetet vetëm shëndetësisë. Pra, një sqarim me i thuktë me qenë rreth këtyre shpenzimeve.

**Afrim Limani** – Është edhe një pjesë e obligimeve që janë bartur nga viti i kaluar, që janë paguar kryesisht nga pozicioni i pagave d.m.th. shtesat për punëtorët në shëndetësi, për punëtorët në arsim dhe inspektorët. Nga ky pozicion paguhen edhe punëtorët të cilët janë me Caritas, për pjesën e punëve shtesë që e kanë bërë. Pra krejt këto janë nga pozicioni i pagave dhe kjo është arsyeja se shifra është më e lartë. Mirëpo, siç e thash edhe në fillim se pa marr parasysh sa shpenzohen atëherë nëse kemi deficit të buxhetit Ministria e Financave duhet me rimbursue atë, sepse pjesën e buxhetit në kuadër të pozicionit të pagave e kemi të buxhetuar dhe gjithashtu e kemi edhe me ligj edhe nuk guxojnë me i marr mjetet tona.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimet, rreth pyetjes sime që e bëra, ndoshta edhe koleget e mi pajtohen që për mbledhjen e kuvendit që pjesën për dreka zyrtare nuk e shoh si diçka në rregull që kuvendi me i shpenzue 1700 euro kurse gjendja reale është ndryshe d.m.th. në kuadër të kësaj që është një OJQ si Eksodi 99, që e kanë një vendim edhe neve na adresohet edhe shihet si shpenzim i kuvendit për dreka. Unë do të kujdesem që për mbledhjen tjetër të radhës që të shohim se çka mund të vendosim që për OJQ-në Eksodi 99, me i ndihmua në forma tjera dhe të largohet kjo që i adresohet kuvendit si shpenzim që realisht nuk është diçka reale. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P – 05864-0 Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për dhënien e pronës së paluajtshme e cila është në zonën kadastrale në Rahovec, në vendin e quajtur Perzhina e evidentuar sipas certifikatës së pronës Nr.05864-0 në emër të komunës së Rahovecit me sipërfaqe prej 20 ari e 31m2. Ju kërkoj falje që për këtë mbledhje nuk kemi mundur me përgatit edhe skicat edhe terrenin për me i prezantuar në projektor por ju premtoj që për mbledhje të kuvendit do ta keni materialisht edhe në projektor që me pas mundësi me u orientue që me pae se ku gjinden këto prona. Propozoj që afati kohor për dhënien e pëlqimit për këto prona të jete 15 vite. Ftojë anëtarët e KPF-së që të aprovojnë pikën për me dërgua në kuvend.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e dëgjuam drejtorin që na prezantoi këtë propozim për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, edhe dihet se këto do të shkojnë përmes procedurave të ankandit publik, por ne i kemi këtu 4 pika që dëshirojmë me i dhanë në këtë formë dhe desha me potencua diçka për drejtorin se ndoshta do të ishte mirë me cekë se për çka do të jepen këto prona dhe do të ishte mirë me dedikue në njëfarë mënyre, pasi kjo pronë prej 20 ari e 31m2, por në njëfarë mënyrë për çka do të dedikohet apo shfrytëzohet dhe në momentin kur e shpallni ankandin ndoshta aty i paraqitni kushtet por tani do të ishte mirë me ditë na pak a shumë dhe a keni paraprakisht kërkesa sigurisht të parashtruara nga qytetarët, kështu që ajo na ka nxitë dhe motivue më tutje dhe gjithashtu është mirë që ndodhin këto gjëra që me pas mundësi me i dhanë në shfrytëzim pasi përfitojnë qytetarët dhe komuna gjithashtu ruhet dhe i rritet vlera e pronës. Por, faktikisht do të ishte mirë pasi e di që rastet tjera kanë qenë për blegtori apo diçka tjetër, kështu që do të ishte mirë që edhe për këtë pikë dhe pika tjera me na dhanë një sqarim që me pas mundësi me ditë që pas ankandit për çka jepen këto prona.

**Fehmi Cena** – Ne si kuvendarë çdo herë e kemi përkrahur dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe mendoj se duhet të vazhdoj ky trend sepse është dobi e dy anshme sikur që është e cekur këtu dhe e thënë edhe nga drejtori sepse edhe komuna i arkëton të hyrat e veta pasi shfrytëzohet ajo pronë dhe gjithashtu për qytetarët punësime sigurohen me shumë. Mirëpo natyrisht edhe unë pajtohem me atë se duhet të kemi qartësi më tepër pasi janë disa pika të njëjta sepse këtu janë 20 ari kurse diku tjetër janë disa hektar, kështu që synimi se për çka mendohet me u shfrytëzua ajo veprimtaria që do të ushtrohet aty, psh nëse ceket është kullosë apo tokë bujqësore a do të jetë për bujqësi apo blegtori apo ndonjë biznes tjetër, edhe gjithashtu prezantimi kur do të na ceket sigurisht edhe në ortofoto në projektor në

mbledhje të kuvendit komunal do të kemi një përqendrim më të saktë se ku është ajo parcelë edhe me ditë se për çka do të shfrytëzohet ajo parcelë, pasi që edhe kur jepet për bujqësi apo blegtori janë disa kritere të caktuara. Kështu që është mirë që do të bëhet përmes ankandit publik dhe ne si kuvendarë këtu duhet me dhanë kontributin tonë këtu, më saktësisht veprimtaria mundësisht për secilën pasi secili destinim që mendohet me u dhanë pronë e paluajtshme e komunës se për çka synohet me u përdorë ajo.

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, paraprakisht për secilën parcelë që sjellim në kuvend, fillimisht vinë kërkesat e palëve për me i marr ne shfrytëzim parcelat, kështu që edhe këto edhe parcela tjera që kanë ardhë deri tash për këto 3 vite, qëllimi i tyre ka qenë destinimi bujqësorë dhe ne me qëllim nuk po i paraqesim në lëndë edhe kërkesat e palëve pasi që ato vinë me emër dhe mbiemër dhe ne sipas ligjit nuk e dimë se kush do ti fitojë sepse kur hapet ankandi publik munden me aplikua një apo me shume të interesuar për me i marr këto me qera, kështu që po i ikim kësaj pasi ligji e thotë kështu edhe pse në pikën 3 e thotë qartë se qëllimi është ruajtja dhe rritja e vlerës së këtyre pronave dhe ju jep mundësi qytetareve me vetëpunësuar. Kështu që ne në asnjë rast nuk kemi dhanë prona e as për këto katër që kemi sot për me ndërtuar pa të drejtë pasi duhet me pas leje prej urbanizmit për ndërtim kështu që ne japim vetëm për qëllime bujqësore. Për secilën kërkesë që kemi edhe sot edhe që kemi edhe me herët janë të deponuara në drejtorinë e bujqësisë dhe qëllimi është destinimi bujqësor. Kështu që mundemi me shikua pak paragrafin në pikën 3 kurse pika e 6-të thotë që pas ankandit komuna e lidh një kontratë me fituesit se kush i fiton dhe aty specifikohet saktë se për çka do të përdoret. Unë do të provoj që në pikën 3-të që bashke me zyrën ligjore me përmirësua këtë paragraf edhe me cekë që qëllimi i destinimit është bujqësor apo që të merret me blegtori.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës.

**Rasim Fazliu** – Unë kisha propozuar që të gjitha pikat që janë të kësaj kategorie të kalojnë në pako për mbledhje të kuvendit, kurse pastaj në mbledhje të kuvendit do të shohim.

**Kryesuesi** – Atëherë konstatojmë që pika e 4-të, 5-të, 6-të dhe 7-të kalojnë për kuvendë. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

#### **8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020.**

Të nderuar kolegë për këtë mbledhje nuk ka mundur të merr pjesë z. Sead Rama mirëpo për kuvend do të merr pjesë edhe do ta bën prezantimin, meqenëse ne e kemi raportin vjetor të punës së Komitetit të Auditimit edhe në mënyrë fizike por për sqarime tjera do ta prezanton për mbledhje të kuvendit më gjerësisht.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, unë e kam lexuar me vëmendje edhe e kam analizuar mirë raportin vjetor të Komitetit të Auditimit edhe sigurisht se i kam shqetësimet e mia dhe do ti ngrisë por meqë thatë nuk e kemi këtu prezent zyrtarin që me ne u përgjigj, atëherë edhe ne do ta lëmë për mbledhje të kuvendit sepse ka mjaftë gjëra këtu që me u thanë, siç e ceku edhe drejtori me herët të çështja e subvencioneve, që ka potencuar njëri prej anëtareve të Komitetit që subvencionet e drejtorisë së kulturës nuk ndahen në bazë të rregullores komunale por është një rregullore tjetër e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kështu do të ishte mirë me na dhanë pak sqarim rreth kësaj qoftë drejtori apo kryetari. Kështu që me sa e di, në këtu marrim qëndrim dhe vendim kuvendi komunal kur është çështja me i ndihmua klubet sportive dhe kryetari po na prezanton para neve rreth ndarjes që ju bëhet klubeve sportive apo shoqërive kulturore artistike. Pra, do të ishte mirë me na dhanë ndonjë sqarim rreth kësaj se cila qëndron këtu po më intereson. Po ashtu e kemi faqe 5, diskutimin e Mirsad Shalës ku thotë që ndoshta është bërë ndonjë gabim nga Njësia e Auditimit sepse klubet sportive dhe OJQ-të e ndryshme apo përfituesit individual që përfitojnë nga subvencionet e kësaj drejtorie nuk subvencionohen sipas rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve por në bazë të rregullores së qeverisë së Republikës së Kosovës respektivisht Ministrisë së Financave. Pra do të ishte mirë me na dhanë sqarime rreth këtyre.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, siç e thash edhe me herët se sot z. Shala nuk e kemi këtu por sigurisht se për mbledhje të kuvendit se do të ketë përgjigje për çështjen të cilën ata e kanë diskutuar në njërin prej mbledhjeve që ata e kanë mbajtur me herët. Gjithsesi ne edhe sot do të ju përcjellim përmes sekretarisë që është ngritur kjo çështje. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:



## 9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025.

Te nderuar kolegë kuvendarë, anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorin Artan Asllani nuk e kemi të pranishëm në sallë për shkak të gjendjes me Covid-19 dhe nuk ka mundur me ardh në mbledhje për me bo prezantimin. Neve na ka ardhë një Draft rregullore që është kompania e kontraktuar të merret me këtë draft rregullore për zhvillimin ekonomik për vitin 2021-2025. Kështu që ne para se me fillim mbledhjen e KPF-së, i kemi ftuar ata dhe kemi kërkuar që kjo draft rregullore të plotësohet me të dhënat për pjesën ekzistuese që ata i kanë paraqitë në këtë draft, kështu që duhet të përmirësohen ende edhe disa gjëra dhe me pastaj procedurat për daljen në debat publik. Gjithashtu pas gjendjes aktuale që ka komuna e jonë janë edhe pjesa ku prej vitit 2021-2025 të paraqitura për veprime tjera për zhvillimin ekonomik. Kështu që për mbledhje të kuvendit do ta kemi drejtorin të pranishëm që të bëjë prezantimin për dalje në debat publik. Atëherë konstatohet se edhe pika e nëntë kalon për kuvend. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

## 10. Të ndryshme.

Të nderuar kolegë, në këtë pikë kam një kërkesë për ju, që me kërkesën e drejtorit të Financave z. Afrim Limani ka kërkuar që për mbledhje ta kemi edhe një pikë shtesë, ku bëhet fjalë për bartjen e mjeteve rezervë. **Afrim Limani** - Siç e tha edhe kryesuesi, unë kam një kërkesë për ju, që për mbledhje të kuvendit me qitë edhe një pikë tjetër të rendit të ditës, pra fjala është për bartjen e rezervave. Realisht në vitin 2021 janë dalë dy udhëzime të reja që çdo projekt kapital i nënshtrohet një kriteri, që është një tabelar apo formular që i nënshtrohet kriterëve të shumta. Siç e dimë buxhetin e kemi votuar në shtator të vitit 2020 dhe prej të gjitha këtyre projekteve, janë 8 projekte të cilat nuk kanë kaluar, pra janë vlerësuar negativisht sipas Ministrisë së Financave edhe vlera në totale e këtyre projekteve është 265,000 euro. Kështu që sa për informimin tuaj në raport me komunat tjera qëndrojmë me mirë sepse ka komuna që me shume se gjysma e buxhetit skanë kaluar dhe janë të detyruar me ju nënshtroja edhe kriterëve. Kështu që tash ky udhëzim administrativ na lejon mundësin që edhe një herë mundemi me qitë në kuvend për këto projekte, nuk do të thotë që ne mundemi me i futë projektet e njëjta por mundemi me shtie edhe projekte të reja të cilët deri me tani nuk kanë qenë si projekt i ri sikurse që kemi të drejtë me rishikim të buxhetit me futë. Kështu që për mbledhje të ardhshme në mënyrë që këto mjete mos me na humbë atëherë kemi paraparë që ne seancën e radhës të i fusim edhe projektet që do të kemi, që konsideroj që ne bashkëpunim me drejtorët që kemi biseduar, ndoshta 2 apo 3 projekte me qenë por me rëndësi është që ato mjete të i ndajmë në kuadër të atyre, pasi që numri i projekteve që nuk kanë kaluar janë 8 projekte, që janë në Kulturë, Ekonomi, Bujqësi, Shëndetësi por me rëndësi është që ne me aprovua edhe njëherë këtë vlerë prej 265,000 euro edhe mos me na humb këto mjete.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, gjithsesi që ne jemi që për mbledhje të kuvendit me qenë kjo pikë shtesë por tash kjo nuk i bien si pikë shtesë por si pikë e rregullt por për kryesuesin e kam një vërejtje kolegjiale që pikat të cilat duan me hy kështu për kuvend, duhet që në mbledhje të KPF-së qysh në fillim me cekë, që sapo të hapni mbledhjen të thoni që kemi këto pika por edhe kemi një propozim nga drejtori edhe sigurisht që miratohet në fillim të mbledhjes e jo në pikën në të ndryshme. Kështu që për mbledhje tjera le të jetë kjo dhe nuk duhet ta praktikoni kështu në të ndryshme edhe drejtori tash sigurisht që na kish dhanë sqarime dhe ne jemi ata që themi po apo jo, por tani ne jemi për me thanë po. Kështu që çdo here duhet në fillim futet në rend të ditës dhe është si rregull, pasi në të ndryshme, ne mund të ngrisim çështje të ndryshme të qytetarëve dhe rreth shqetësimeve të tyre kurse pikat e rendit të ditës edhe sigurisht ato shtesë, në fillim të seancës aprovohen. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, gjithsesi ashtu edhe duhet vepruar. Kështu që konstatohet se e kemi edhe pikën shtesë rreth bartjes së mjeteve rezerve. Të nderuar kolegë, faleminderit shumë për kontributin tuaj, shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

